



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:168031

Datë: 10.05.2024

Numri i dokumentit: 05667299

P.nr.776/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Dibran Jusufi, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.G., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.563/20 të datës 23.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 29.04.2024, në prani të prokurores së shtetit Elza Bajrami dhe të akuzuarit E.G. me mbrojtësen e tij sipas autorizimit av. Qëndrim Reçica, me datë 29.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 10.05.2024 me shkrim e përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari E.G., nga babai N., nëna T., e gjinisë J., i lindur me datë, në fshatin, Komuna e Lipjanit, ku edhe tani jeton, me vendqëndrim në shtetin e Zvicrës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i papunësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse prej datës së pacaktuar e deri me datë 24.10.2020, rreth orës 20:10, te rrethi i Çagllavicës, pa leje valide të organeve kompetente, i pandehuri A.R. ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim armën, në kundërshtim me ligjin, në atë mënyrë që, derisa Njësia Speciale Operative, e ka ndaluar automjetin e llojit, me ngjyre te kaltër të cilën e drejtonte E.G. dhe gjatë kontrollit tek i njëjtë kanë gjetur një revole e tipit, kalibër 8mm, me numër serik, ku janë konfiskuar nga ana e policisë.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 40, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së dhe neneve 242 e 364 të KPP-ës, të akuzuarin:

E GJYKON

I. Me dënim me gjobë në shumë prej 1800 € (njëmijë e tetëqind euro) i cili dënim do të ekzekutohet brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pasi aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.

II. Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do t'i caktohet një ditë burgim.

III. Në bazë të nenit 366 paragrafi 3 i KPRK-së nga i akuzuari konfiskohet revolva e tipit Zastava C635, kalibër 8mm, me numër serik, e cilat duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me institucionet tjera relevante, sipas procedurave standarde në fuqi.

IV. Obligohet i akuzuari i lartcekur që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20€ (njëzet euro) dhe shumën prej 20€ (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

-Rrjedha e procedurës penale-

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me datë 27.11.2020, pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzën me numër PP/L.nr.563/2020 të datës 23.11.2020, kundër të akuzuarve E.G. dhe A. R., secili veç e veç për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, me datë 02.03.2023, e ka dorëzuar këtë lëndë pranë Departamentit të Përgjithshëm të kësaj gjykate për shkak të ndryshimit të Kodit të Procedurës Penale me numër 08/L-032, i cili ka hyrë në fuqi me datë 17.02.2023, me të cilin vepra penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, bie në kompetencë lëndore pranë Departamentit të Përgjithshëm.

Me datë 04.03.2024, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar, në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit Rukije Sheshivari dhe i akuzuari A. R. me mbrojtësen e tij të caktuar sipas autorizimit avokaten Flutura Selimi, ndërsa nga mbrojtësi i të pandehurit E.G. është pranuar njoftimi se i mbrojturi i tij sërish nuk mund të marrë pjesë në seancë për shkakun se i njëjti ndodhet në shtetin e Zvicrës, andaj gjyqtari i vetëm gjykues me qëllim të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës e ka veçuar procedurën penale ndaj të pandehurit E.G..

Me datë 26.04.2024, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar, në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit Elza Bajrami dhe i akuzuari E.G. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit avokatin Qendrim Reqica. Në këtë seancë prokurorja e shtetit e ka lexuar aktakuzën lëndore, me ç ‘rast i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë me ç ‘rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 të KPRK-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të akuzuarit.

-Vlerësimi i pranimit të fajësisë-

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të akuzuarit për veprën penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 242 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezentë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejt natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza, e po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

-Gjendja faktike e vërtetuar-

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe se

në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të kësaj vepre penale.

-Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit-

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-së.

Gjithashtu, gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, i njëjti është penduar, i vjen keq për rastin dhe ka premtuar se nuk do të përsërisë më veprime të tilla, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti faktin se i njëjti edhe më parë ka qenë i gjykuar me aktgjykim të formës së prerë dhe atë për vepër të njëjte penale sipas aktgjykimit me numër P.nr.657/2021. Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-së, të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

-Vendimi lidhur me konfiskim-

Gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 276 par. 1 dhe 2 të KPP-së, si dhe në bazë të nenit 366 paragrafi 3 i KPRK-së, nga i akuzuari konfiskohet arma e tipit Zastava C635, kalibër 8mm, me numër serik e sekuestruar nga Policia e cilat duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me institucionet tjera relevante, sipas procedurave standarde në fuqi. Gjykata, ka vërtetuar se i pandehuri nuk posedonte leje, e as autorizim për posedim, për më tepër, arma e lartcekur bën pjesë në sendet që konfiskohen në mënyrë automatike, andaj gjykata ka vendosur të konfiskoj përherë këto armë, si dhe ka urdhëruar shkatërrimin e tyre, pasi që ekziston baza ligjore për konfiskimin e përhershëm të armëve, ashtu siç përcaktohet me nenin 276 të KPP-së dhe nenin 366 par.3 të KPRK-së, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm.

-Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale-

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së. Ndërsa, për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga se u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.776/24, më datë 10.05.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues
Dibran Jusufi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.